



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK**

(Adresa,Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës e-mail:info@vaudejes.gov.al)

PROPOZIM

“Për humbjen e mandatit të anëtarit të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës”

Komisioni i mandateve të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës, mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”i ndryshuar , neni 49, pika 2,pika 4 germa e, pika 5 dhe neni 54 germa j, i propozon Këshillit të Bashkisë Vau Dejës, të:

PROPOZOJMË

1.Miratimin e humbjes së mandatit të anëtarit të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës,Znj.Kristjana Kovaçi.

Komisioni i Mandateve:

Z. Neki Kapllanaj – Kryetar 

Z. Marin Dodaj – Sekretar 

Znj. Kristjana Kovaçi – Anëtar (*humb mandatin*)



Mbledhje e Komisionit të Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut.

Data 25.03.2025

RAPORT VENDIMMARRJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr. 4 datë 11/03/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Shkurt 2025"

Analiza ligjore:

Bazuar në ligjin nr. 139, datë 17.12.2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", të ndryshuar; Ligjin nr. 57/2019, datë 18.7.2019, "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë"; VKM-në nr. 597, datë 4.9.2019, "Për Përcaktimin e Procedurave të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për Ndihmën Ekonomike", të ndryshuar, Si dhe bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 02, datë 27.01.2025, "Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike duke përdorur deri në 6% të fondit të ndihmës ekonomike për vitin 2025"; Shkresën e Prefekturës së Qarkut Shkodër për shprehje ligjshmërie nr. 106/1 prot, datë 11.02.2025.

Situata aktuale e funksionit:

Situata financiare : 1-Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara për muajin Shkurt 2025 familje 129, me 464,647 lekë, me 5.98% e fondit total.

Drejtoria / Sektori përgjegjës:

Sektori i Fuqizimit Ekonomik, Drejtoria e Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Turizmit, Rinisë dhe Sportit Sektori i Ndihmes Ekonomike dhe Pak kane relatuar për projekt vendimin.

Monitorimi dhe raportimi: Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut dhe Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik dhe Mbikqyrjes Financiare dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e buxhetit dhe do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Drejtorinë përgjegjëse.

Impakti social / grupet që preken: Ky projekt mbetet një mundësi e shkëlqyer për të kontribuar në përmirësimin e kushteve të jetesës së fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre, si dhe në forcimin e rrjetit të mbështetjes sociale që është kaq i nevojshëm për komunitetin.



A është objekt i konsultimit publik: Nuk është objekt i konsultimit publik

Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut , i mbledhur me datën 25/03/2025, shqyrtoi projekt vendimit nr.4 datë 11/03/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin "Projekt Vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Shkurt 2025" paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

- kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- miratimin e projektaktit

Bashkëlidhur **argumentat e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës** i paraqitur në procesverbalin e mbledhjes së Komisionit

Albina Dvradhi

(emri, mbiemri, firma)

Kryetar i Komisionit

Meluhë Zyberaj

(emri, mbiemri, firma)

Zv Kryetar i Komisionit

Souje Selje

(emri, mbiemri, firma)

Sekretar i Komisionit

**RAPORT VENDIMMARRJE**

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr.8 datë 20/03/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për "Për miratim e Plani Social Vendor 2025-2028, të Bashkisë Vau Dejës"..

Analiza ligjore: Në mbështetje ligjin nr. 139 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar; ligji nr 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë"; Ligji nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë"; Ligji nr. 104/2014, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë"; Ligji nr.10107/2009, "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë"; Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; Ligji nr. 8137/1996 "Për ratifikimin e Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore" (FZ 20-1996) dhe Relacionit të administratës së Bashkisë Vau Dejës; i propozojmë Këshillit të Bashkisë Vau Dejës.

Situata aktuale e funksionit: Ky plan është hartuar duke ndjekur një qasje të thelluar, të bazuar në të dhëna dhe konsultime të gjera me aktorët lokalë, për të siguruar një kuptim të plotë të sfidave dhe prioriteteve të Bashkisë Vau Dejës. Procesi i hartimit ka përfshirë disa hapa të rëndësishëm, të cilat i paraqesim më poshtë:

1. Grumbullimi dhe analizimi i të dhënave relevante: Të dhënat janë mbledhur nga Bashkia Vau Dejës, regjistri i gjendjes civile, statistikat kombëtare dhe raportet e institucioneve të tjera relevante për të siguruar një analizë të plotë të situatës sociale.
2. Konsultime me aktorët lokalë dhe shoqërinë civile: Janë zhvilluar konsultime me grupe të ndryshme të interesit, përfaqësues të shoqërisë civile, dhe grupe vulnerabël, për të përfshirë pikëpamjet e tyre në hartimin e planit.
3. Identifikimi i boshllëqeve në shërbimet sociale: Bazuar në raportet e monitorimit dhe përvojën e institucioneve vendore, janë identifikuar boshllëqe në ofrimin e shërbimeve sociale, të cilat duhen adresuar urgjentisht.
4. Qasje pjesëmarrëse: Komuniteti është përfshirë aktivisht në diskutime për të garantuar një përfaqësim të drejtë dhe për të zhvilluar politika sociale që janë në përputhje me nevojat e qytetarëve.

Ky plan është ndërtuar mbi një analizë të detajuar të situatës sociale në Bashkinë Vau Dejës, duke adresuar faktorët kyç si shkalla e varfërisë, papunësia, struktura demografike dhe aksesimi në shërbime sociale. Plani synon të plotësojë boshllëqet ekzistuese dhe të krijojë ndërhyrje të qëndrueshme për grupet më në nevojë.



Për të garantuar zbatimin efektiv të planit dhe për të monitoruar ndikimin e politikave sociale, është përfshirë një mekanizëm të qartë monitorimi dhe vlerësimi. Ky mekanizëm do të mundësojë ndjekjen e progresit dhe përshtatjen e ndërhyrjeve për t'iu përgjigjur nevojave emergjente. Nëpërmjet këtij plani, Bashkia Vau Dejës synon të krijojë një model të qëndrueshëm të mbështetjes sociale dhe të përmirësojë cilësinë e jetës për qytetarët e saj. Ky plan përfaqëson angazhimin e Bashkisë për forcimin e përfshirjes sociale dhe transparencës, duke ndihmuar në zhvillimin e shërbimeve sociale dhe përmirësimin e mbrojtjes sociale në nivel vendor.

Situata financiare :

Drejtoria / Sektori përgjegjës:

Drejtoria E Mbrojtjes, Përfshirjes Dhe Strehimit Social ka relatuar për projekt vendimin

Monitorimi dhe raportimi: Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut dhe Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik dhe Mbikqyrjes Financiare dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e buxhetit dhe do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Drejtorinë përgjegjese.

Impakti social / grupet që preken: Ky projekt mbetet një mundësi e shkëlqyer për të kontribuar në përmirësimin e kushteve të jetesës së fëmijëve me aftësi të kufizuar dhe familjeve të tyre, si dhe në forcimin e rrjetit të mbështetjes sociale që është kaq i nevojshëm për komunitetin.

A është objekt i konsultimit publik: Janë zhvilluar konsultime me grupe të ndryshme të interesit, përfaqësues të shoqërisë civile, dhe grupe vulnerabël, për të përfshirë pikëpamjet e tyre në hartimin e planit.

Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut , i mbledhur me datën 25/03/2025, shqyrtoi projekt vendimit nr.8 datë 20/03/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin "Projekt Vendim "Për miratim e Plani Social Vendor 2025-2028, të Bashkisë Vau Dejës" paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

2. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

b) miratimin e projektaktit

Albiarë Divardhi Kryetar i Komisionit

(emri, mbiemri, firma)

Melika Zyberaj Zv.Kryetar i Komisionit

(emri, mbiemri, firma)

Sonije Salje Sekretar i Komisionit

(emri, mbiemri, firma)



Data 25.03.2025

RAPORT VENDIMMARRJE**Drejtuar:** Këshillit të Bashkisë**Lenda:** Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr. 6 datë 19/03/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për "Për miratimin e ndryshimit të VKB NR.33 dt.28.04.2023 dhe VKB NR 80 dt.30.10.2023 për ngritjen e Komisionit të Strehimit"**Analiza ligjore:** Në mbështetje të nenit 24, pika 2, neni 54 gërman" e Ligjit nr 139/2015, datë 17.12.2015" Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; Ligji nr 22/2018 Për strehimin social" i ndryshuar, neni 2 pika 51: VKM nr. 384, datë 12.06.2019 Për përcaktimin e dokumentacionit. për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore", me propozimin e Sektorit të Strehimit Social.**Situata aktuale e funksionit:** Qëllimi është krijimi i një kuadri rregullator për mënyrën e përbërjes dhe funksionimit të Komisionit të Strehimit, për një veprimtari më efiçente dhe transparente ndaj të tretëve, të përcaktuar nga aktet ligjore dhe nënligjore të Republikës së Shqipërisë. Ky Komision në përputhje me normat juridike, duhet që, sa herë në Bashkinë Vau Dejës ka në zbatim një program. social strehimi, të shqyrtojë kërkesat dhe dokumentacionin për të bërë të mundur, vlerësimin teknik sipas sistemit të pikëzimit të miratuar në Këshillin Bashkiak, të listës emërore të personave aplikues, me qëllim sigurimin e transparencës dhe efiçencës së tij si organ kolegjal përballë aplikuesve.**Situata financiare :** Nuk ka buxhet**Drejtoria / Sektori përgjegjës:**

Drejtoria E Mbrojtjes, Përfshirjes Dhe Strehimit Social ka relatuar për projekt vendimin

Monitorimi dhe raportimi: Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e buxhetit dhe do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Drejtorinë përgjegjëse.**Impakti social / grupet që preken:** Ky projekt mbetet një mundësi e shkëlqyer për të kontribuar në përmirësimin e kushteve të jetesës së fëmijëve me aftësi të kufizuar dhe familjeve të tyre, si dhe në forcimin e rrjetit të mbështetjes sociale që është kaq i nevojshëm për komunitetin.



A është objekt i konsultimit publik: Nuk ka nevoje per konsultime me publikun.

Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut , i mbledhur me datën 25/03/2025, shqyrtoi projekt vendimit nr.6 datë 19/03/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin "Për miratimin e ndryshimit të VKB NR.33 dt.28.04.2023 dhe VKB NR 80 dt.30.10.2023 për ngritjen e Komisionit të Strehimit" paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

- a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- b) miratimin e projektaktit

Albino Divadhi

(emri, mbiemri, firma)

Kryetar i Komisionit

Melike Zyberaj

(emri, mbiemri, firma)

Zv.Kryetar i Komisionit

Sonije Salje

(emri, mbiemri, firma)

Sekretar i Komisionit



Mbledhje e Komisionit të Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut.



Data 25.03.2025

RAPORT VENDIMMARRJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr. 7 datë 19/03/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin "Për pranimin e të moshuarës zj. Lizë Sulkuqe në Qendrën e përkujdesit rezidencial për të moshuar "Besa", Barbullush

Analiza ligjore:

Bazuar në Ligjin 139 2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" e ndryshuar, në ligjin 121 2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" në vkm 518, datë 04.09.2018" Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masen e shumës për shpenzimet personale për përfituesit e shërbimit të organizuar" Kreu III Pika 13. A): pika 14; pika 17; pika 18; pika 23 a) pika 24; Kreu IV" Kriteret e përfitimit të shërbimit dhe përmbajtja e dosjes" Pika 58, c) pika 59; si dhe bazuar në formularin e verifikimit të gjendjes sociale ekonomike të të moshuarit.

Situata aktuale e funksionit: Mbështetur në kërkesën e paraqitur pranë Sektorit të Shërbimit Social. Bashkia Vau Dejës të zj.Lizë Sulkuqe për sistemimin e saj në qendrën për të moshuar "BESA" Barbullust, ju paraqesim propozimin tonë për miratim nga sita juaj. Zj. Lizë Sulkuqe është shprehur se jeton prej disa vitesh tek të afërm të basakëshortit pasi bashkëshorti i ka vdekur. Nuk ka të afërm të tjerë për tu përkujdesur për të. Për më periudhë ka jetuar tek të afërm të bashkëshortit pasi nuk kan banesë, por e ka të pamundur të qëndroje me gratë për shkak të problematikave social-ekonomike. E gjendur në një situatë të tillë dhe pa mbështetje nga te afërmit kërkon që të sistemohet në një qendër të moshuarish pasi socializimi me there do bënte që të kalonte ditë më të qeta dhe më të lumtura.

Situata financiare :

Drejtoria / Sektori përgjegjës: Drejtoria E Mbrojtjes, Përfshirjes Dhe Strehimit Social ka relatuar për projekt vendimin.

Monitorimi dhe raportimi: Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e buxhetit dhe do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Drejtorinë përgjegjëse.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Impakti social / grupet që preken: Ky projekt mbetet një mundësi e shkëlqyer për të kontribuar në përmirësimin e kushteve të jetesës së fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre, si dhe në forcimin e rrjetit të mbështetjes sociale që është kaq i nevojshëm për komunitetin.

A është objekt i konsultimit publik: Nuk është objekt i konsultimit publik

Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut, i mbledhur me datën 25/03/2025, shqyrtoi projekt vendimit nr.7 datë 19/03/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin "Për pranimin e të moshuarës zj. Lizë Sulkuqe në Qendrën e përkujdesit rezidencial për të moshuar "Besa", Barbullush, paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

- kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- miratimin e projektaktit

Albano Liradhi

(emri, mbiemri, firma)

Kryetar i Komisionit

Melike Ziberaj

(emri, mbiemri, firma)

Zv.Kryetar i Komisionit

Sonije Salja

(emri, mbiemri, firma)

Sekretar i Komisionit



Mbledhje e komisionit të financave, buxhetit, pasurive Bashkiake dhe planifikimit të zhvillimit strategjik të Bashkisë, mbikqyrjes financiare.

Data 25.03.2025

RAPORT VENDIMMARRJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr. 2 datë 04/03/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për "Miratimin e Tavanëve Përgatitore të Shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 për Bashkinë Vau Dejës".

Analiza ligjore: Mbështetur në nenin 9 pika 1.3, neni 34 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar; neni 34 të ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore"; ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008. "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" të ndryshuar. Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të NJQV"; Udhëzimit nr 8 datë 28.02.2025 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm vendor 2026-2028" dhe relacionit të administratës së Bashkisë Vau Dejës,

Situata aktuale e funksionit:

Planifikimi i të ardhurave nga taksat & tarifatat është mbështetur në disa faktor, llojet e taksave, bazën e taksueshmë, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështu edhe pagimit, kohën e kryerjes së tyre, efektet e lehtësive, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë, të cilat janë të percaktuara në dokumentin "Pakete Fiskale", e cila përcakton rregullat për mënyrën e ushtrimit të të drejtave dhe të detyrave nga organet e qeverisjes vendore, për vendosjen e taksave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre.

Në mënyrë të hollësishme, përveç strukturimit, detajon çdo lloj takse të administruar nga organet vendore të administrimit, përcakton qartë edhe administrimin e saj duke filluar me mënyrën e llogaritjes, personat

përgjegjës të pagimit të taksës dhe ato të mbledhjes së saj. Paketa fiskale e Bashkisë Vau dejes për këtë kategori e hartuar dhe e ndryshuar

edhe me përfshirjen e përfaqësuesve të komunitetit të biznesit e më konkretisht biznesit të madh dhe të vogël, banorëve të njësive administrative, përfaqësues të komunitetit sipas interesit, këshilltarë etj., pasqyron disa politika të rëndësishme për uljen e disa niveleve ligjore/kufi, etj. sipas kompetencave ligjore.

Situata financiare :

Të ardhurat e veta, që mbledhen nga administrata e Bashkisë në vitet 2026-2028 parashikohen që të kenë një trend rritje për tre vitet e ardhshme.



Kategoritë e taksave dhe tarifave që ndikojnë më shumë në planin e të ardhurave nga burimet e veta për vitet 2026-2028 janë kryesisht taksa e pasurisë së paluajtshme që zë rreth 26%, taksa e mjeteve te perdorura që zë rreth 12%, tarifa për pastrimin që zë rreth 21 %, tarifa e ndriçimit publik që zë rreth 5%, tarifa të tjera ku përfshihen tarifat nga institucionet kulturore dhe tarifa administrative zëzë rreth 20%. Këto zëra kryesorë mbulojnë rreth 83% të planit të të ardhurave të Bashkisë Vau Dejes.

Parashikimi i shpenzimeve do të jete per 2026 1,109, 315,000 Leke, per 2027 1,132,830,000 leke dhe per 2028 1,145,856,000 Leke

Drejtoria / Sektori përgjegjës:

Drejtoria e Ekonomike dhe e Menaxhimit Financiar ka relatuar përpara komisionit

Monitorimi dhe raportimi: Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik dhe Mbikqyrjes Financiare dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e buxhetit dhe do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Drejtorinë Ekonomike dhe të Menaxhimit Financiar ose Drejtorinë përgjegjëse për zbatimin e projekteve të caktuara.

Impakti social / grupet që preken: Programi Buxhetor Afatmesem 2025-2027 dhe Buxheti Vjetor per vitin 2025 impakton jetën të gjitha shtresave, kategorive dhe zhvillimin e të gjithë territorit të Bashkisë Vau i Dejës

Komisioni i Përhershëm për "Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik dhe Mbikqyrjes Financiare" , i mbledhur me datën 25/03/2025, shqyrtoi projekt vendimit nr.2 datë 04/03/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin "Miratimin e Tavanëve Përgatitore të Shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 për Bashkinë Vau Dejës, paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1.T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

- kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- miratimin e projektaktit

Neki Kaplloni Kryetar i Komisionit
(emri, mbiemri, firma)

Arben Mehmeti Zv.Kryetar i komisionit
(emri, mbiemri, firma)

Florian Tomajli Sekretar i Komisionit



Mbledhja e komisionit Bujqesise, pyjeve, menaxhimit te ujërave , mbrojtjes mjedisit dhe biodiversitetit.

Data 25.03.2025

RELACION

Komisioni u mbledh në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, Njesia Administrative Bushat dhe shqyrtoi projekt vendimin e mëposhtëm:

Projekt vendim për miratimin e planit të masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin Pyjor e Kullosor për vitin 2025.

Komisioni u mbledh në sallën e mbledhjeve të Njesisë Administrative Bushat, dhe shqyrtoi projekt vendimin e paraqitur nga Drejtoria e pyjeve, turizmit dhe mbrojtjes së mjedisit dhe konkludoi se hartimi i projekt vendimit ishte bazuar në ligj dhe se për këtë vit është i nevojshëm dhe i domosdoshëm miratimi i këtij projekt vendimi respektimi i të cilit çon në zvogelimin e rrishtit, mbrojtjen e fondit pyjorë nga zjarret e mundshme. Komisioni i propozon Këshilltarëve të kalojnë për miratim projekt vendimin e sipercituar në mbledhjen e muajit Mars 2025

Kryetar

Kastriot Shkjau

Zv/Kryetare

Mirela Vasija

Sekretar

Aleko Dodani